



31 korrik 2026

RAPORT PËR VLERËSIMIN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË HC LUMBARDHI I

1. Hyrje

1. Ky Raport është hartuar me qëllim të vlerësimit të procesit të dhënies në shfrytëzim (me qira) të Hidrocentralit "Lumbardhi I", aset i cili është pjesë e aseteve të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë elektrike që administrohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS), në kuadër të të drejtave dhe obligimeve që burojnë nga Licenca për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).
2. Raporti është përgatitur pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ZRRE nga KEDS, korrespondencës ndërinstitucionale, dokumentacionit të procedurës së përzgjedhjes së operatorit ekonomik, analizës së dispozitave ligjore dhe rregullative në fuqi, si dhe dokumenteve kontraktuale që ndërlidhen me shfrytëzimin e këtij hidrocentrali.
3. Objektivi i këtij raporti është të vlerësojë nëse procedura e ndjekur për dhënien në shfrytëzim të HC "Lumbardhi I" është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, kushtet e Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, aktet rregullative të ZRRE-së, dhe parimet që garantojnë mbrojtjen e interesit publik dhe të konsumatorëve.
4. Përveç aspektit procedural dhe juridik, raporti analizon edhe ndikimin ekonomik të marrëveshjes së lidhur nga ana e KEDS me operatorin ekonomik KELKOS, duke vlerësuar përfitimet financiare që rrjedhin nga shfrytëzimi i hidrocentralit, raportin ndërmjet të ardhurave të gjeneruara dhe kompensimit të paraparë për qiradhënësin, si dhe ndikimin potencial të kësaj marrëdhënieje kontraktuale në asetet që administrohen në interes të konsumatorëve të energjisë elektrike.

2. Korniza Ligjore dhe Rregullative

1. Veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS), përfshirë administrimin dhe shfrytëzimin e aseteve të licencuara që përdoren për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, rregullohet nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Energjinë, aktet nënligjore të Zyrës së Rregullatorit për Energji, si dhe nga kushtet e Licencës për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes, të lëshuar nga ZRRE. Këto akte përcaktojnë jo vetëm të drejtat e operatorit të licencuar, por edhe kufizimet dhe obligimet që ai duhet t'i respektojë gjatë administrimit të aseteve që përdoren për ofrimin e shërbimit publik të shpërndarjes së energjisë elektrike.
2. Duhet të theksohet qartë se Hidrocentrali "Lumbardhi I" përbën një aset publik, i cili administrohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në kuadër të aktivitetit të licencuar dhe nuk mund të trajtohet si aset me të cilin operatori mund të disponojë lirisht sipas diskrecionit të tij. Përkundrazi, çdo veprim



juridik që ndikon në mënyrën e administrimit ose të shfrytëzimit të këtij aseti duhet të jetë në përputhje me kushtet e licencës dhe t'i nënshtrohet mekanizmave mbikëqyrës të përcaktuar nga ZRRE.

3. Po ashtu duhet të theksohet se, pas sqarimit të dhënë nga Ministria e Ekonomisë lidhur me kompetencat institucionale, ZRRE nuk ka kundërshtuar iniciimin dhe zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e operatorit ekonomik, duke e konsideruar se zhvillimi i procedurës tenderuese duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, ky qëndrim nuk përbënte miratim për lidhjen e marrëveshjes së qirasë dhe nuk e lironte KEDS-in, nga obligimet që burojnë nga kushtet e licencës. Përkundrazi, ZRRE kishte bërë të qartë se, pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes dhe para lidhjes së marrëveshjes me operatorin ekonomik të përzgjedhur, KEDS kishte detyrim të ndiqte të gjitha veprimet nevojshme sipas kornizës ligjore në fuqi, KU sipas Nenin 12 të Licencës së OSSH-së, përcaktohet saktë që: “I licencuari mund të bëjë tjetërsimin e ndonjë aseti të tillë (dhënien me qera në rastin konkret) vetëm pas miratimit me shkrim nga Rregullatori”, pra, në përputhje me kushtet e Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.

4. Ky obligim paraqet një kërkesë procedurale me karakter formal, dhe përbën një mekanizëm thelbësor të mbikëqyrjes rregullative. Përmes këtij mekanizmi, ZRRE vlerëson nëse një tjetërsim që ka për objekt një aset publik është në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk cenon ushtrimin e aktivitetit të licencuar, nuk dëmton interesin publik dhe siguron që përfitimet ekonomike nga shfrytëzimi i aseteve të administruara në kuadër të licencës të jenë në përputhje me interesin e konsumatorëve.

5. Në rastin e HC Lumbardhi I, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se marrëveshja e qirasë është lidhur pa u zhvilluar paraprakisht procedura e miratimit formal nga ZRRE, ndonëse një obligim i tillë buronte nga kushtet e licencës. Si rrjedhojë, ZRRE nuk ka pasur mundësi të ushtrojë kompetencën e saj rregullative për të vlerësuar paraprakisht kushtet juridike, ekonomike dhe rregullative të marrëveshjes së propozuar, përpara krijimit të marrëdhënies kontraktuale ndërmjet KEDS-it dhe operatorit ekonomik.

6. Pikërisht për këtë arsye, analiza e këtij Raporti fokusohet jo vetëm në respektimin formal të procedurave, por edhe në vlerësimin nëse kushtet e marrëveshjes së lidhur kanë garantuar mbrojtjen e interesit publik dhe të konsumatorëve, duke pasur parasysh se asetet që administrohen në kuadër të licencës nuk shërbejnë për realizimin e interesit privat të operatorit të licencuar, por për ofrimin e një shërbimi publik dhe krijimin e vlerës ekonomike në dobi të konsumatorëve.

3. Përshkrimi i Projektit

HC Lumbardhi I, i njohur më parë si HC Kozhnjer, është hidrocentral ekzistues i ndërtuar gjatë viteve 1950–1957 dhe gjendet në komunën e Deçanit, në rrjedhën e lumit Deçan/Bistrica e Deçanit. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, hidrocentrali ka kapacitet të instaluar prej rreth 8.2 MW. Prodhimi vjetor i parashikuar sipas planit të biznesit është rreth 22 GWh/vit, ndërsa për vitin e parë të operimit është parashikuar prodhim më i ulët, përkatësisht 17 GWh, për shkak të periudhës së paraparë të rifillimit të operimit.

Në aspektin kontraktual, projekti lidhet me dhënien me qira të HC Lumbardhi I nga KEDS tek konsorciumi KELAG & KELKOS/Kelkos Energy, pas zhvillimit të procedurës tenderuese me titull “Dhënia



me qira e Hidrocentralit”. Sipas dokumenteve të tenderimit dhe njoftimit për dhënie të kontratës, oferta e përzgjedhur ka qenë në vlerë prej 3,000,000 EUR pa TVSH, ndërsa kontrata e qirasë është paraparë për periudhë 20-vjeçare, me pagesë mesatare prej 150,000 EUR/vit, përkatësisht 12,500 EUR/muaj.

Qëllimi i projektit është vënia në funksion dhe operimi i hidrocentralit për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, duke përfshirë edhe aktivitetet e nevojshme të rehabilitimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese.

4. Vlerësimi i të Ardhurave nga Prodhimi

Vlerësimi i të ardhurave nga prodhimi i HC Lumbardhi I është bërë duke marrë për bazë kapacitetin e instaluar prej 8.2 MW dhe prodhimin e parashikuar vjetor sipas planit të biznesit të aplikuesit. Sipas të dhënave të përdorura në modelin ekonomik-rregullativ, prodhimi i parashikuar është 17,000 MWh për vitin 2026, ndërsa për periudhën 2027–2045 prodhimi vjetor është parashikuar në nivel prej 22,000 MWh/vit. Në total, për periudhën 20-vjeçare të qirasë, prodhimi i parashikuar arrin në rreth 435,000 MWh.

Ky nivel i prodhimit nënkupton një faktor të shfrytëzimit të kapacitetit prej rreth 33%, duke marrë parasysh orët e disponueshme të operimit, ndërprerjet e planifikuara dhe ndërprerjet e detyruara.

a. Vlera e parashikuar e kësaj energjie në treg me shumicë

Për qëllime të vlerësimit ekonomik, energjia e prodhuar nga HC Lumbardhi I është krahasuar me vlerën e saj të mundshme në treg me shumicë, duke përdorur skenarë të çmimeve të tregut/importit. Në modelin ekonomik-rregullativ është përdorur si skenar bazë çmimi i shitjes me shumicë prej 77.27 EUR/MWh i cili rrjedh nga planifikimi i palës, ndërsa si skenarë potencial janë marrë edhe çmimet e shitjes me shumicë prej 65 EUR/MWh deri 110 EUR/MWh.

Për vlerësimin e sasisë së parashikuar të energjisë së prodhuar nga HC Lumbardhi I në tregun me shumicë, është marrë për bazë prodhimi vjetor i parashikuar prej 22,000 MWh. Me qëllim të vlerësimit të ndjeshmërisë së të ardhurave ndaj ndryshimit të çmimit të energjisë, janë analizuar disa skenarë të çmimeve të shitjes në treg me shumicë, duke filluar nga 65 €/MWh deri në 110 €/MWh.

Në të gjithë skenarët është supozuar se prodhimi vjetor mbetet i pandryshuar në nivelin prej 22,000 MWh, e poashtu shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet operative mbeten konstante. Konkretisht, qiraja vjetore është marrë në vlerë prej 150,000 €, ndërsa shpenzimet operative janë marrë në vlerë prej 697,400 €. Si rezultat, shpenzimet totale vjetore, që përfshijnë qiranë dhe shpenzimet operative, arrijnë në 847,400 €.

Në bazë të këtyre supozimeve, vlera vjetore e energjisë së prodhuar nga HC Lumbardhi I varion nga 1,430,000 € në skenarin me çmim 65 €/MWh, deri në 2,420,000 € në skenarin me çmim 110 €/MWh. Pas zbritjes së shpenzimeve totale vjetore prej 847,400 €, përfitimet e mundshme vjetore variojnë nga 582,600 € në skenarin më konservativ, deri në 1,572,600 € në skenarin më të lartë të çmimit.



Duke qenë se periudha e kontratës së qirasë është 20 vite, përfitimet e parashikuara janë vlerësuar edhe në nivel kumulativ për gjithë periudhën e qirasë. Në këtë kuptim, përfitimet totale për periudhën 20-vjeçare variojnë nga 11,652,000 € në skenarin me çmim 65 €/MWh, deri në 31,452,000 € në skenarin me çmim 110 €/MWh.

Në skenarin bazë prej 77.27 €/MWh, i cili korrespondon me vlerën e parashikuar prej rreth 1,700,000 € në vit, përfitimi vjetor pas zbritjes së qirasë dhe shpenzimeve operative është 852,600 €. Për periudhën 20-vjeçare, ky përfitim arrin në rreth 17,052,000 €

Tabela në vijim paraqet vlerën e parashikuar të energjisë për secilin skenar të çmimit, si dhe përfitimet e mundshme vjetore dhe kumulative për periudhën 20 vjeçare:

Skenarët	Prodhimi (MWh)	Çmimi (€/MWh)	Vlera (€)	Qiraja (€)	Shpenzime operative (€)	Gjithsej shpenzime (€)	Përfitimet vjetore (€)	Përfitimet për 20 vite (€)
Skenari 1	22,000.00	65.00	1,430,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	582,600.00	11,652,000.00
Skenari 2	22,000.00	70.00	1,540,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	692,600.00	13,852,000.00
Skenari 3	22,000.00	77.27	1,700,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	852,600.00	17,052,000.00
Skenari 4	22,000.00	80.00	1,760,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	912,600.00	18,252,000.00
Skenari 5	22,000.00	85.00	1,870,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	1,022,600.00	20,452,000.00
Skenari 6	22,000.00	90.00	1,980,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	1,132,600.00	22,652,000.00
Skenari 7	22,000.00	95.00	2,090,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	1,242,600.00	24,852,000.00
Skenari 8	22,000.00	100.00	2,200,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	1,352,600.00	27,052,000.00
Skenari 9	22,000.00	105.00	2,310,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	1,462,600.00	29,252,000.00
Skenari 10	22,000.00	110.00	2,420,000.00	150,000.00	697,400.00	847,400.00	1,572,600.00	31,452,000.00

Nga analiza rezulton se përfitimet e mundshme nga operimi i HC Lumbardhi I janë ndjeshëm të varura nga çmimi i shitjes së energjisë në treg me shumicë. Meqenëse shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet operative mbeten të pandryshuara në të gjithë skenarët, çdo rritje e çmimit të energjisë reflektohet drejtpërdrejt në rritjen e përfitimeve vjetore dhe të përfitimeve kumulative për periudhën 20-vjeçare.

Kjo analizë tregon se projekti është shumë i ndjeshëm ndaj çmimit të shitjes së energjisë në treg me shumicë. Meqenëse shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet operative mbeten të pandryshuara në të gjithë skenarët, çdo rritje e çmimit të energjisë reflektohet drejtpërdrejt në rritjen e përfitimeve. Për këtë arsye, vlerësimi i të ardhurave të mundshme nga HC Lumbardhi I duhet të bëhet jo vetëm mbi bazën e të ardhurave bruto, por edhe duke marrë parasysh strukturën e shpenzimeve, rreziqet e tregut, rreziqet hidrologjike dhe kushtet reale të shitjes së energjisë.

b. Vlera e parashikuar e kësaj energjie sipas Planit të Biznesit të aplikuesit Lumbardhi I

Sipas Planit të Biznesit të aplikuesit, të ardhurat nga prodhimi i energjisë elektrike janë parashikuar në nivel prej 1.2 milion EUR për vitin 2026, bazuar në prodhim prej 17,000 MWh. Kjo nënkupton një çmim mesatar të nënkuptuar prej rreth 70.6 EUR/MWh për vitin e parë të operimit.

Për vitet pasuese, përkatësisht për periudhën 2027–2045, plani parasheh prodhim vjetor prej 22,000 MWh dhe të ardhura vjetore prej 1.7 milion EUR. Kjo korrespondon me një çmim mesatar të nënkuptuar prej rreth 77.27 EUR/MWh.

Në total, sipas Planit të Biznesit, për periudhën 20-vjeçare priten:

Treguesi

Vlera



Prodhimi total i parashikuar	435,000 MWh
Të ardhurat totale të parashikuara	33,500,000 EUR
Të ardhurat mesatare vjetore viti 2026	~1,200,000 EUR/vit
Të ardhurat mesatare vjetore 2027-2045	~1,700,000 EUR/vit
Çmimi mesatar i vlerësuar për gjithë periudhën	~77.27 EUR/MWh

Nga krahasimi i të dhënave rezulton se vlera e parashikuar në Planin e Biznesit është në linjë me skenarin bazë sipas planit të biznesit prej rreth 77.27 EUR/MWh, sidomos për periudhën pas vitit 2026. Për periudhën 2027–2045, plani i aplikuesit paraqet të ardhura vjetore prej 1.7 milion EUR, të cilat përputhen me vlerën e energjisë së prodhuar nëse aplikohet çmimi prej 77.27 EUR/MWh.

Në këtë aspekt, të ardhurat e parashikuara sipas Planit të Biznesit të aplikuesit paraqesin një bazë për vlerësimin ekonomik të aktivitetit të prodhimit të HC Lumbardhi I gjatë periudhës së qirasë. Krahasuar me vlerën totale të qirasë prej 3,000,000 EUR, të ardhurat bruto të parashikuara prej 33.5 milion EUR për periudhën 20-vjeçare tregojnë se qiraja përfaqëson rreth 9% të të ardhurave bruto të parashikuara.

5. Vlerësimi i Shpenzimeve Operative të Operimit të këtij Gjeneratori

5.1 Shpenzimet operative dhe zhvlerësimi

Analiza e shpenzimeve operative është bazuar në modelin ekonomik-rregullativ të përgatitur për projektin. Gjatë rillogaritjes janë përditësuar kostot e rrjetit, zhvlerësimi, kostoja e borxhit dhe parametrat financiarë, duke ruajtur të pandryshuara supozimet kryesore të planit të biznesit. Kjo qasje mundëson një vlerësim më realist të kostove operative përgjatë periudhës së analizës.

Tabela në vijim paraqet projeksionin e kostove sipas kategorive kryesore për periudhën 2026–2045, ndërsa kostoja totale e projektuar e operimit për këtë periudhë vlerësohet në rreth 17.37 milion €.



Viti	Tarifa rrjeti (€)	Koncesion real (€)	Kosto e kthimit mbi borxhin	Kosto tjera (€)	Zhvlerësimi (€)	Kosto totale (€)
2026	96,900	150,000	102,861	229,000	112,000	690,761
2027	125,400	150,000	102,861	312,000	112,000	802,261
2028	126,654	150,000	102,861	319,000	112,000	810,515
2029	127,921	150,000	102,861	325,000	112,000	817,781
2030	129,200	150,000	102,861	332,000	112,000	826,061
2031	130,492	150,000	102,861	338,000	112,000	833,353
2032	131,797	150,000	102,861	345,000	112,000	841,657
2033	133,115	150,000	102,861	352,000	112,000	849,975
2034	134,446	150,000	102,861	359,000	112,000	858,307
2035	135,790	150,000	102,861	366,000	112,000	866,651
2036	137,148	150,000	102,861	374,000	112,000	876,009
2037	138,520	150,000	102,861	381,000	112,000	884,380
2038	139,905	150,000	102,861	389,000	112,000	893,766
2039	141,304	150,000	102,861	396,000	112,000	902,165
2040	142,717	150,000	102,861	404,000	112,000	911,578
2041	144,144	150,000	102,861	412,000	112,000	921,005
2042	145,586	150,000	102,861	421,000	112,000	931,446
2043	147,041	150,000	102,861	429,000	112,000	940,902
2044	148,512	150,000	102,861	438,000	112,000	951,373
2045	149,997	150,000	102,861	446,000	112,000	960,858
Kostot Totale	2,706,586	3,000,000	2,057,216	7,367,000	2,240,000	17,370,802

Për qëllime të analizës ekonomike është përgatitur një projeksion i kostove të operimit të hidrocentralit për periudhën e mbetur të koncesionit prej 20 viteve, duke u bazuar në të dhënat e Planit të Biznesit, parametrat e modelit ekonomik-rregullativ dhe supozimet e përdorura në këtë analizë.

Kostot e rrjetit janë llogaritur duke aplikuar tarifat aktuale të rrjetit që paguhen nga gjeneratorët për shërbimet e transmetimit, të shumëzuara me prodhimin vjetor të energjisë elektrike. Për periudhën projektuese është supozuar një indeksim vjetor prej 1%, me qëllim të reflektimit të rritjes graduale të tarifave.

Kostoja e koncesionit është marrë sipas vlerës së kontratës së dhënies me qira, e cila rezulton nga oferta e procedurës së prokurimit dhe është konsideruar konstante gjatë gjithë periudhës së analizës. Kostoja e qirasë është trajtuar si një komponent fiks i kostove operative. Në model është përdorur vlera reale e kontratës prej 150,000 € në vit, e cila është analizuar në raport me të hyrat dhe kostot totale për të vlerësuar ndikimin e saj në performancën financiare.

Kostoja e kthimit mbi borxhin është llogaritur duke supozuar se 40% e investimeve kapitale financohen me borxh, ndërsa pjesa tjetër me kapital vetanak. Për këtë qëllim është përdorur norma e kostonë së borxhit e përfshirë në modelin ekonomik-rregullativ. Kjo kosto është e trajtuar më poshtë tek kapitulli 6.1.

Kostot e tjera operative janë marrë nga Plani i Biznesit i KELKOS dhe, për qëllime të kësaj analize, nuk janë rishikuar apo korrigjuar nga ZRRE. Këto kosto përfaqësojnë pjesën e mbetur të shpenzimeve



operative të nevojshme për funksionimin e hidrocentralit, duke përfshirë, ndër të tjera, pagat, mirëmbajtjen rutinore, transportin, tarifat për shfrytëzimin e ujit, shërbimet komunale dhe shpenzime të tjera operative.

6. Investimet kapitale e parashikuara ne 20 vitet e ardhshme

Për qëllime të kësaj analize është vlerësuar nevoja për investime kapitale gjatë periudhës së mbetur të operimit të hidrocentralit, me synim ruajtjen e kapacitetit prodhues dhe sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të aseteve. Duke qenë se nuk ka qenë në dispozicion një vlerësim i detajuar i gjendjes teknike dhe i vlerës së mbetur të aseteve, investimet kapitale janë vlerësuar bazuar në praktikat e zakonshme ndërkombëtare për hidrocentrale, sipas të cilave investimet vjetore për rehabilitim dhe mirëmbajtje madhore zakonisht variojnë ndërmjet 1% dhe 3% të investimit fillestar. Për këtë analizë është përdorur vlera mesatare prej 2% të investimit fillestar prej 11.2 milion €, që korrespondon me një investim vjetor prej 224,000 €, ose 4.48 milion € gjatë 20 viteve të mbetura të koncesionit. Duke supozuar një jetë ekonomike prej 40 viteve, analiza është zhvilluar për periudhën e mbetur të operimit prej 20 viteve.

6.1 Kostoja e Parashikuar e Kapitalit

Për vlerësimin e koston së kapitalit është përdorur si referencë metodologjia e ZRRE-së për përcaktimin e Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) për aktivitetet e rregulluara të rrjetit. Edhe pse hidrocentrali nuk është aset i rregulluar, përdorimi i këtij parametri ofron një bazë të përshtatshme krahasuese për vlerësimin ekonomik të investimit.

Në analizë është përdorur një WACC reale para tatimit prej 7.69%, i cili aplikohet për segmentet e rregulluara të rrjeteve me strukturë financimi të supozuar prej 40% borxh dhe 60% kapital vetanak. Në këtë bazë, investimi i supozuar prej 4.48 milion € është ndarë në 1.792 milion € financim me borxh dhe 2.688 milion € financim me kapital vetanak.

Kostoja vjetore e financimit është vlerësuar në rreth 102,861 € për borxhin dhe 241,382 € për kapitalin vetanak, duke rezultuar në një kthim total mbi kapitalin prej rreth 344 mijë € në vit. Ky rezultat është verifikuar edhe përmes kontrollit me WACC, i cili jep një vlerë pothuajse identike.

6.2 Shpenzimet e Amortizimit

Shpenzimet e amortizimit janë llogaritur duke marrë si bazë investimin kapital të supozuar prej 4.48 milion €, i cili përfaqëson investimet e planifikuara gjatë 20 viteve të mbetura të koncesionit.

Duke supozuar një jetë ekonomike prej 40 viteve, amortizimi është llogaritur sipas metodës lineare, duke rezultuar në një shpenzim vjetor prej 112,000 €.

7. Benefitet e dhënies me qira të këtij gjeneratori për qiradhënësin dhe qiramarrësin

Dhënia me qira e hidrocentralit krijon përfitime ekonomike për palët e përfshira, duke mundësuar shfrytëzimin efikas të asetit dhe gjenerimin e të hyrave gjatë periudhës së koncesionit.



Për qiradhënësin, përfitimi kryesor konsiston në realizimin e të hyrave të qëndrueshme nga qiraja gjatë gjithë periudhës së kontratës, pa bartur kostot dhe rreziqet që lidhen me operimin e hidrocentralit. Në skenarin bazë prej 3 milion €, të hyrat nga qiraja janë 150,000 € në vit, ndërsa në skenarin alternativ prej 5 milion €, ato arrijnë në 250,000 € në vit.

Për qiramarrësin, përfitimi buron nga operimi i hidrocentralit dhe realizimi i të hyrave nga prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike. Bazuar në rezultatet e modelit ekonomik, projekti mbetet financiarisht i qëndrueshëm edhe pas përfshirjes së kostos së koncesionit, kostove të rrjetit, zhvlerësimit, kostove të borxhit dhe kostove të tjera operative.

Konsumatorët mund të përfitojnë në rast se të hyrat nga qiraja reflektohen në uljen e kostove të njohura në tarifa.

Tabela xx: paraqet në mënyrë përmbledhëse benefitet kryesore të dhënies me qira për secilën nga palët e përfshira në analizë.

Pala	Përfitimet kryesore
Për qiradhënësin	Dhënia me qira krijon të ardhura të parashikueshme nga asetë gjatë periudhës 20-vjeçare. Në skenarin 3 mil. €, përfitimi është 150,000 €/vit; në skenarin 5 mil. €, përfitimi është 250,000 €/vit.
Për konsumatorët	Nëse të ardhurat nga qiraja reflektohen në analizën tarifore, konsumatorët përfitojnë përmes uljes së kostove të njohura në tarifë.
Për qiramarrësin	Qiramarrësi përfiton nga operimi komercial i gjeneratorit, duke realizuar të hyra nga shitja e energjisë dhe fitim operativ pasi të mbulohej qiraja, kostot e rrjetit dhe kostot operative.

8. Përfundimi

Ky raport paraqet rezultatet e analizës ekonomike dhe financiare të përgatitur mbi bazën e të dhënave të disponueshme, Planit të Biznesit dhe modelit ekonomik-rregullativ të zhvilluar për vlerësimin e implikimeve të kontratës së dhënies me qira të HC Lumëbardhi I.

Në kuadër të analizës janë vlerësuar kostot operative, investimet kapitale të supozuara, kostoja e kapitalit, amortizimi, si dhe benefitet ekonomike për qiradhënësin dhe qiramarrësin. Për këtë qëllim janë përdorur parametrat dhe supozimet e modelit ekonomik-rregullativ, si dhe praktikrat e zakonshme ndërkombëtare në rastet kur nuk kanë qenë në dispozicion të dhëna të detajuara për vlerësimin e aseteve dhe investimeve kapitale.

Rezultatet e analizës ofrojnë një bazë analitike për vlerësimin e implikimeve ekonomike dhe financiare të kontratës, duke paraqitur ndikimin e parametrave kryesorë financiarë në operimin e hidrocentralit gjatë periudhës së mbetur të koncesionit.

Duhet theksuar se ZRRE nuk disponon metodologji apo standarde të veçanta për vlerësimin e vlerës së një biznesi ose të nivelit të kostos së koncesionit të arritur ndërmjet palëve kontraktuese. Për rrjedhojë, kjo analizë nuk ka për qëllim të vlerësojë nivelin e çmimit të kontraktuar, por të paraqesë implikimet ekonomike dhe financiare të kontratës, bazuar në informacionin dhe supozimet e përdorura në modelin ekonomik-rregullativ.



Përveç gjetjeve ekonomike dhe financiare të paraqitura më sipër, nga analiza e kornizës ligjore dhe rregullative rezultojnë se procedura e dhënies në shfrytëzim të HC "Lumbardhi I" duhet të vlerësohet edhe në raport me obligimet që burojnë nga kushtet e Licencës për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes. Në këtë drejtim, duhet theksuar se ZRRE kishte njoftuar KEDS-in se mund të vazhdonte me iniciimin dhe zhvillimin e procedurës për përzgjedhjen e operatorit ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, ky njoftim nuk zëvendësonte procedurën e miratimit të përcaktuar në Nenin 12 të Licencës, sipas së cilës, para dhënies në shfrytëzim të një asemi të licencuar, KEDS kishte obligim të paraqiste kërkesë formale në ZRRE dhe të siguronte miratimin paraprak me shkrim të Rregullatorit.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezultojnë se procedura e miratimit paraprak nga ZRRE nuk është zhvilluar para dhënies në shfrytëzim të HC "Lumbardhi I". Si rrjedhojë, nuk është përmbushur një nga kushtet themelore të Licencës për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes, duke pamundësuar ushtrimin e kompetencës së ZRRE-së, për të vlerësuar paraprakisht nëse disponimi i këtij asemi publik që administrohet nga i licencuari KEDS, përmes dhënies në shfrytëzim, ishte në përputhje me kushtet e Licencës, legjislacionin në fuqi dhe interesin publik.

Mekanizmi i miratimit paraprak nuk përbën vetëm një kërkesë procedurale me karakter formal, por është një instrument thelbësor i mbikëqyrjes rregullative, përmes të cilit ZRRE ushtron kompetencën e saj për të vlerësuar nëse disponimi i një asemi publik që administrohet nga i licencuari KEDS, është në përputhje me objektivat e rregullimit të sektorit energjetik dhe garanton administrimin e këtij asemi publik në interes të konsumatorëve.

Nga analiza e paraqitur në këtë raport rezultojnë se procedura e miratimit paraprak, e paraparë me Nenin 12 të Licencës, nuk është vendosur vetëm për të garantuar respektimin formal të procedurave, por për t'i mundësuar ZRRE-së ushtrimin e kompetencës së saj rregullative në vlerësimin e disponimit të aseteve publike që administrohen nga i licencuari. Përmes këtij mekanizmi, Rregullatori vlerëson nëse dhënia në shfrytëzim e një asemi publik është në përputhje me kushtet e Licencës, legjislacionin në fuqi dhe interesin publik, duke siguruar që administrimi dhe shfrytëzimi i këtyre aseteve të mos shërbejë vetëm për realizimin e interesit ekonomik të operatorit ekonomik, por edhe për krijimin e vlerës ekonomike në dobi të konsumatorëve.

Prandaj, nga aspekti juridik dhe rregullativ konstatohet se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në Nenin 12 të Licencës për Operimin e Sistemit të Shpërndarjes, pasi procedura e miratimit paraprak me shkrim nga ZRRE nuk është zhvilluar para lidhjes së marrëveshjes së qerasë për dhënien në shfrytëzim të asemi publik që administrohet nga i licencuari KEDS. Si pasojë, ZRRE nuk ka ushtruar kompetencën e saj rregullative për të vlerësuar paraprakisht nëse disponimi i këtij asemi ishte në përputhje me kushtet e Licencës, legjislacionin në fuqi dhe interesin publik, si dhe nëse mënyra e shfrytëzimit të tij garantonte që vlera ekonomike e krijuar nga një aset publik të reflektonte në mënyrë të drejtë edhe në dobi të konsumatorëve.